



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____, Prot.

Tiranë, më _____._____.2021

VENDIM
Nr. 253, datë 15.06.2021

PËR
ANULIMIN E PJESSHËM TË VENDIMIT NR.210, DATË 20.05.2021, TË KËSHILLIT
TË LARTË GJYQËSOR

Këshilli i Lartë Gjyqësor, bazuar në nenet 109, shkronja “b”, 113 dhe 117, pika 2, të Kodit të Procedurave Administrative, si dhe në nenin 97, pika 3, të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, pas njoftimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec sipas Shkresës nr. 100 prot., datë 11.06.2021, dërguar me postë elektronike dhe protokolluar me aktin nr. 2798, datë 11.06.2021, mbasi konstatoi që paragrafi I, nëndarja “Gjykata e Rrethit Gjyqësor Pogradec”, i Vendimit të tij nr.210, datë 20.05.2021, “Për caktimin e gjyqtarëve për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në gjykata të tjera, të ndryshme nga ajo ku ushtrojnë funksionet në mënyrë të përhershme”, është marrë në shkelje të dispozitave lidhur me procedurën administrative të përcaktuar në Vendimin e tij nr.30, datë 14.02.2019, “Për rregullat dhe procedurat e caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme”,

VENDOSI:

1. Anulimin e pikës 1, nëndarja “Gjykata e Rrethit Gjyqësor Pogradec”, paragrafi I, të Vendimit nr.210, datë 20.05.2021, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”, “Për caktimin e gjyqtarëve për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në gjykata të tjera, të ndryshme nga ajo ku ushtrojnë funksionet në mënyrë të përhershme”.
2. Një kopje e vendimit i njoftohet gjyqtarit z. Besnik Shehu, Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec dhe Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR